



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 486 Prot.

Tiranë, më 03.04 2018

**VENDIM Nr. 58, datë 20.03.2018**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4, datë 20.03.2018, pasi shqyrtoi Raportin e gërmimit arkeologjik në korridorin e ndërtimit të **Gazsjellësit TRANS ADRIATIK PIPELINE(TAP)**, në zonën e Uznovës, KM 149 + 737-subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e gërmimit arkeologjik në korridorin e ndërtimit të **Gazsjellësit TRANS ADRIATIK PIPELINE(TAP)**, në zonën e Uznovës, KM 149 + 737-subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS"
2. Të devijojë gjurma e linjës së Gazsjellësit TRANS ADRIATIK PIPELINE(TAP), në zonën e gërmuar, të realizohet mbulimi kësaj zone, me qëllim ruajtjen *in situ* të strukturave të zbuluara gjatë gërmimit arkeologjik.
3. Të vijojnë punimet e ndërtimit të tubacionit të Linjës së gazsjellësit TAP, duke u kryer ndjekja në mënyrë periodike ditore e punimeve të gërmimit, sipas akt-marrëveshjes tre palëshe, të lidhur ndërmjet "SPIECAPAG Shqipëria", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe ASHA, të përcaktuar në pikën 3 të vendimit të KKA Nr. 76, datë 15.07.2016, për projektin "Linja e Gazsjellësit TRANS ADRIATIK (TAP), Fushata e parë (KM 211.8 - KM 145).

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)

4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**

**RUDINA ZOTO**

---

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@usha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@usha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)